

S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

HEKTA GROUP

KAPITULLI I  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1  
Ortaket e Shoqerise

Me Aktin e Themelimit te dates 28/09/2020,

**Z. Agustin Elmaz Malaj**, me numer personal G90627121M, i lindur me date 27/06/1969, banues ne Durres ne lagjen nr.5, qytetar shqiptar, titullar i leternjoftimit nr. 035899058;

**Z. Ardian Qazim Hoxha**, me numer personal G406070510, i lindur me date 07/06/1964, banues ne Durres ne lagjen nr.3, rruga Skenderbej, qytetar shqiptar, titullar i leternjoftimit nr. 034222032;

**Z. Idlir Qazim Hoxha**, me numer personal G90223173I, i lindur me date 23/02/1969, banues ne Durres ne lagjen nr.1, rruga Taulantia, qytetar shqiptar, titullar i leternjoftimit nr. 034282714;

themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar  
**HEKTA GROUP**.

NENI 2  
Kohezgjatja

Shoqeria **HEKTA GROUP** eshte nje person juridik i te drejtes shqipetare qe operon si e tille nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Aktiviteti i saj do te rregullohet konform dispozitave te ketij Statuti, te Aktit te Themelimit bashkangjitur dhe te legjisacionit shqiptar ne fuqi.

Kohezgjatja e aktivitetit vendoset te jete **e pacaktuar**, por kjo mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se per gjithshme.

NENI 3  
Objekti i aktivitetit

Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj :  
"Perpunimin, prodhimin, shperndarjen, tregetimin e miellit dhe  
nenprodukteve te tij, dritherave dhe nenprodukteve te tyre,  
import-export te mallrave ushqimore, bujqesore, blegtoriale, si  
dhe te ushqimeve te koncentruara per blegtorine, himet etj.

NENI 4  
Selia

Selia e shoqerise vendoset te jete ne Fier, Mbrostar Ura, Zona  
Kadastrale Nr.2636, Nr.pasurie 35/10.

KAPITULLI II  
KAPITALI SHOQEROR DHE KUOTAT

NENI 5  
Kapitali shoqeror

Kapitali shoqeror fillestar eshte ne vleren 1.000.000 leke  
(njemilion), i perbere nga tre kuota si me poshtë:

- Nje kuote, ne masen 57% te kapitalit fillestar me vlore 570.000 leke ne zoterim te z. Agustin Malaj,
- Nje kuote, ne masen 22% te kapitalit fillestar me vlore 220.000 leke ne zoterim te z. Ardian Hoxha,
- Nje kuote, ne masen 21% te kapitalit fillestar me vlore 210.000 leke ne zoterim te z. Idlir Hoxha.

NENI 6  
Kuotat

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet

- a. kontributit ne kapital,
- b. shitblerjes,
- c. trashegimise
- d. dhurimit
- e. cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Kalimi i kuotave behet me ane te nje kontrate me shkrim.

NENI 7  
E Drejta e parablerjes

Nese nje ortak ka ndermende t'u shese apo t'u transferoje te  
treteve, teresisht apo pjeserisht, kuoten e tij, ortakeve te  
tjere u rezervohet e drejta e parablerjes.

Per te lejuar ushtrimin e kesaj te drejte ortaku qe don te  
shese duhet te lajmeroje me leter rekomande me kthim per gjigje



Page 2 of 9

te gjithe ortaket, duke specifikuar çmimin e shitjes, menyren e pageses dhe emrat e bleresve te mundshem.

Komunikimi i te drejtes se parablerjes duhet t'i arrije ortakut ofrues, me leter rekomande me pergjigje, brenda 30 diteve nga data qe ortaku i interesuar per blerje ka marre njoftimin me oferten e shitjes.

Nese ortaku nuk pergjigjet brenda 3(tre)muajve nga data e komunikimit, aprovimi konsiderohet i dhene.

Nese ortaku refuzon (me shkrim) aprovimin, brenda 3 muajve eshte i detyruar te bleje ose te aprovoje blerjen e kuotes ne favor te bleresit te gjetur nga ortaku ofrues, me te njejtin cmim dhe menyre likujdimi qe ai ka specifikuar ne njoftim.

NENI 8

Ndryshimet ne kapital vendosen nga Asamblea e Pergjithshme. Rritja e kapitalit, mund te behet ne te holla, ne natyre, si dhe nga rezervat dhe fitimet e pashperndara.

KAPITULLI III  
ASAMBLEA E PERGJITHSHME

NENI 9

Asamblea e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise. Vendimet e saj merren konform legjislacionit ne fuqi si dhe te ketij statuti, dhe jane te detyrueshme per te gjithe ortaket.

Ato verbalizohen ne nje register te vecante sic e kerkon ligji. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

NENI 10

Asamblea e Pergjithshme vendos per :

- o politikat tregetare,
- o ndryshimet ne Statut,
- o emerimin, shperblimin e shkarkimin e Administratorit, te likuidatorit apo Audituesit Ligjor,
- o Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga Administratori, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- o miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- o zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
- o ndarjen e fitimeve te mundshme sipas nenit 76,77,78 te ligjit dhe krijimin e rezervave,
- o trasferimin dhe cedimin e kuotave,
- o perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit,
- o riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,

- o miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese.

#### NENI 11

Asamblea e per gjithshme mund te mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji dhe qdo here qe konsiderohet e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise, por te pakten nje here ne vit. Thirrjet e Asamblese behen nen kujdesin e Administratorit, me leter rekomande ose me poste elektronike te pakten 7 dite te plota para mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje rendin e dites, daten, oren dhe vandin e mbledhjes.

(Me dite te plota nenkuptohet e gjithe periudha duke lene jashte diten e lajmerimit dhe diten e mbledhjes).

#### NENI 12

Cdo ortak mund te perfajesohet me nje autorizim, i vlefshem vetem per nje mbledhje, qe perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite, nga nje i trete qe nuk eshte Administrator.

I takon Administratorit te konstatojne te drejten e pjesemarrjes.

Ortaket ose perfajesuesit e tyre mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblese Pergjithshme edhe nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen, audio ose audio-video konform nenit 88 te ligjit.

#### NENI 13

Asamblea drejtohet nga Administratori, i cili emeron edhe nje sekretar per mbajtjen e procesverbalit te mbledhjes.

Vendimet e Asamblese nenshruhen nga te gjithe ortaket prezente ose te deleguarit e tyre.

Kur ligji e parashikon, si dhe kur drejtuesi i Asamblese e konsideron te arsyeshme, verbali hartohet nga nje noter.

#### NENI 14

Te gjitha vendimet e Asamblese se per gjithshme regjistrohen ne procesverbale te cilet ruhen nen pergjegjesine e Administratorit.

Ne procesverbalin qe permboj daten dhe vandin e mbledhjes, rendin e dites, emrat e atij qe drejton mbledhjen e te atij qe mban procesverbalin dhe rezultatet e votimit, bashkangjitet lista e pjesemarresve si dhe akti i thirrjes se Asamblese se per gjithshme.

Procesverbalet e mbledhjes nenshruhen nga kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

NENI 15

Ne rastin e vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asamblea e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave e kapitalit.

Ne rastin e vendimeve qe kerkojne nje shumice te kualifikuar, Asamblea e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese personalisht ortaket qe zoterojne me shume se 50% e votave.

Nese Asamblea e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me siper, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 16

Asamblea e per gjithshme vendos me 3/4 e votave te ortakeve pjesemarres, per ndryshime ne statut, rritje apo zvogelim te kapitalit te shoqerise, ndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shkrirjen e shoqerise.

Per ceshtjet e tjera te parashikuara nga nenii 81 i ligjit Asamblea e per gjithshme vendos me shumice te zakonshme.

NENI 17

Asamblea e per gjithshme gezon te drejten t'i kerkoje Gjykates anullimin e vendimeve te Administratorit kur keto shkojne kunder legjislacionit ne fuqi apo ketij statuti.

Eshte Asamblea qe ngarkon se kush do ta perfaqesoje shoqerine ne Gjykate.

Te drejtat e te treteve mbeten te paprekura ne te tilla raste.

KAPITULLI IV  
ADMINISTRIMI

NENI 18

Administrimi dhe perfaqesimi i shoqerise i besohet nje **Administratori te Vetem**, qe mund edhe mos te jete ortak. Administratori emerohet me Vendim te Asamblese, per nje afat maksimal 5 vjet, nga regjistrimi i shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, me te drejtë ripërtëritjeje dhe rri ne detyre deri kur jep doreheqjen ose shkarkohet nga Asamblea se Pergjithshme.

Me vendim unanim te Asamblese, per administrimin e aktivitetit te shoqerise emerohet Administrator i Vetem

**z.Ralf Ardián Hoxha**, me numer personal J310040820, i lindur me date 04/10/1993, banues ne Durres ne lagjen nr.3, rruga Skenderbej, qytetar shqiptar, titullar i pasaportes nr.



BC0269790, te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit ligjor te shoqerise ne perputhje me ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" neni 95.

NENI 19

Administratori ka te gjithe kompetencat per realizimin e objektit te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe i jane dhene eskluzivisht Asamblese se per gjithshme nga Akti i Themelimit dhe nga ky Statut.

**Administratorit i kufizohet e drejta e shitjes se aseteve te shoqerise me vlore mbi 1.000.000 leke(njemilion) pa marre miratimin e Asamblese se Pergjitheshme.**

Administratori ka te drejten e tij dhe detyrohet te :

- administrojne veprimtarine tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregetare,
- te perfaqesojne shoqerine,
- te kryejne te gjitha levizjet e nevojshme per administrimin e zakonshem te aktivitetit konform politikave dhe strategjive te vendosura nga Asambleja e per gjithshme dhe te raportoje per realizimin e tyre,
- te kujdesen qe dokumentacioni ne per gjithesi dhe librat kontabel te mbahen te rregullt dhe konform normale ligjore ne fuqi,
- te pergatisin dhe te nenshkruaje bilancin vjetor dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet Asamblese per miratim,
- te krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- te kryejne regjistrimet e parashikuara nga ligji prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit, si dhe çdo ndryshim i tyre do te paraqiten prane Qendres Kombetare te Biznesit per t'u regjistruar.

NENI 20

Shperblimi i Administratorit vendoset nga Asambleja dhe duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e tyre dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, Asamblea mund te vendosse reduktimin e shperblimit te Administratorit.

Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te Administratorit ne strukturen e kostove te shoqerise tregetare publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 21

Administratori ka per detyre:

- a. te kryejne detyrat e percaktuara nga ligji dhe nga ky statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis,
- b. te ushtrojne kompetencat qe i njihen me ligj ose ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara,
- c. te vleresoje me perqegjesi ceshtjet per te cilat do marre vendim,
- ç. te parandalojne dhe te menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqerise,
- d. te garantojne miratimin e marreveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 te nenit 13 te ligjit per rastet e konfliktit te interesit,
- e. te ushtrojne detyren e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e duhur.
- f. te leshojne certifikaten e aftesise paguese te shoqerise e cila konfirmon qe dividentet e propozuar plotesojne kerkesat e ligjit.

NENI 22

Administratori gjate detyres, pergjigjet para shoqerise apo te treteve qe pesojne deme nga mosrespektimi i ligjit, Aktit Themelues apo ketij Statuti.

Administratori pergjigjet personalisht, finanziarisht por jo vetem, para shoqerise dhe/ose te treteve qe kane pesuar deme nga ndonje veprim i tij jo ligjor.

I takon atyre te demostrojne qe kane kryer detyren ne menyre te rregullt dhe konform normave te kerkuara.

Administratori pergjigjet para shoqerise per vlefshmerine e certifikaten e aftesise paguese te shoqerise te leshuar nga ata vete.

NENI 23

Administratori mund te shkarkohen me vendim te Asamblese se per gjithshme ose me vendim te Autoritetit Gjyqesor.

KAPITULLI V  
VITI USHTRIMOR, BILANCI, NDARJA E FITIMIT

NENI 24

Viti ekonomik ushtrimor mbylllet me 31 Dhjetor te çdo viti.

Viti i pare ushtrimor do te mbylllet me 31 Dhjetor 2018.

Ne fund te çdo ushtrimi do te hartohen bilanci dhe pasqyrat e tjera vjetore konform legjisacionit ne fuqi.

NENI 25

Asamblea pas aprovimit te bilancit dhe pasqyrave financiare, brenda dates 30 qershore vendos mbi destinimin e fitimit.

Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakeve, gjithnjë ne proporcione me kuotat e kapitalit që secili ka ne pronesi, vetem nese pas pagimit te dividentit :

- a. Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj,
- b. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.

KAPITULLI VI  
PRISHJA DHE LIKUJDIMI

NENI 26

Akti Themelues, Statuti dhe aktet e tjera te shoqerise mund te konsiderohen te pavlefshem vetem ne rast se shkelin dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " ose ne Kodin Civil.

NENI 27

Shoqeria prishet vetem nese :

- me vendim te Asamblese se per gjithshme,
- me perfundim te afatit te aktivitetit te shoqerise, nese ai eshte ndryshuar dhe percaktuar me vendim te Asamblese se per gjithshme,
- me hapjen e procedurave te falimentimit,
- nese nuk ka kryer veprimtari tregetare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise prane Qendres Kombetare te Biznesit, sipas normave ligjore ne fuqi,
- me vendim te Gjykates.

NENI 28

Me perjashtim te rasteve kur eshte nisur një procedure falimentimi, prishja e shoqerise ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 29

Me fillimin e procedurave te likujdimit Asamblea e per gjithshme emeron likuidatorin e shoqerise, te drejtat dhe detyrimet per te perfaqesuar shoqerine si dhe shperblimin e tij.

Administratori paraqet prane Qendres Kombetare te Biznesit te dhenat e likuidatorit dhe dokumentat qe lidhen me te.

Likuidatori depoziton prane Qendres Kombetare te Biznesit firmen e tij dhe ne vazhdim deklaron atje çdo ndryshim te mundshem qe ka lidhje me identitetin apo kompetencat e likuidatorit.


Likuidatori zevendeson Administratorin me te gjithe kompetencat e tij nga dita e emerimit te tij.

**NENI 30**

Persa nuk specifikohet shprehimi i kete statut, vlejne normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**O R T A K E T**

Agustin Malaj



Ardian Hoxha



Idlir Hoxha

